

Fillimi > -Kronikë

Me çantë shpine në transport publik/ Sekuestrohen 5 mina me telekomandë në Shijak, arrestohet 44-vjeçari, reagon policia

13 Shtator, 2022 13:16



Madhësia e tekstit: - +

- DURRËS**
- Pesë mina me telekomandë janë sekuestruar në Durrës nga forcat e policisë së qytetit bregdetar.
- Gazetarja Klodiana Lala raportoi për “BalkanWeb” se operacioni ka nisur nga mbrëmja e kaluar dhe ka vijuar deri ditën e sotme.
- Pas lajmit të raportuar në “BalkanWeb”, reagoi zyrtarisht dhe policia, e cila njofton se ka arrestuar një 44-vjeçar, i cili do t'i shiste 5 kallëpet e C4 dhe 5 kapsollat detonatore.

Shijak/ Evidentohet dhe goditet një tjetër rast i tentativës për tregtim të lëndëve eksplozive.

Finalizohet operacioni policor i koduar “Stacioni”. Transportonte 5 kallëpë lëndë eksplozive C4 dhe 5 kapsolla detonatore, arrestohet në flagrancë 44-vjeçari.

Gjenden dhe sekuestrohen lëndët plasëse. Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Shijak, në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative, se një shtetas transportonte lëndë eksplozive me qëllim tregtimin e tyre, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Stacioni”, në kuadër të të cilit u arrestua në flagrancë shtetasi:

-F. D., 44 vjeç, banues në Manzë, Durrës, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”.

44-vjeçari u kap në flagrancë në Maminas, kur sapo kishte zbritur nga një automjet i transportit publik.

Gjatë kontrollit të ushtruar në çantën e shpinës së të arrestuarit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 5 kallëpë lëndë plasëse C4 dhe 5 kapsolla detonatore.

Vijon puna, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për identifikimin dhe kapjen e personit që do të blinte lëndët plasëse, si dhe për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të veprimtarisë kriminale të shtetasit F. D.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit 'Balkanweb' mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: Durrës mina me telekomandë policia

TË NGJASHME

- Policia e Shtetit/ Muhamet Rumbullaku thirrje strukturave vendore: Objektivat e vendosura të përmbushen në 100 ditë**
13 Shtator, 2022
- Prezantohet sot plani i menaxhimit të zonave arkeologjike në Durrës, Iglj Cara: U përjashtuan shoqëria civile, opozita e media! Për qeverinë, çudia më e madhe 3 ditë zgjat**
13 Shtator, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

- Humbi kontrollin e motomjetit, plagoset 65-vjeçari në Potam të Himarës**
13 Shtator, 2022
- Thyen moratoriumin/ Gjuanin shpendë në mënyrë të paligjshme, e pësojnë 3 gjuetarë në Shkodër**
13 Shtator, 2022
- Sulmet kibernetike në Shqipëri, REL: Çfarë dihet për grupin HomeLand Justice?**
13 Shtator, 2022
- Aksident në Astir, kamioni përplas për vdekje këmbësoren, detajet e para**
13 Shtator, 2022
- U arrestua për sulmin në Gramsh, mbliidhen para në 'Instagram' për të paguar avokatin për rusen e dyshuar për spjunazh**
13 Shtator, 2022
- VIDEO/ E rëndë në Mamurras, shëkëputet ballkoni i katit të pestë dhe përfundon një kat më poshtë, tmerrohen banorët**
13 Shtator, 2022

KATEGORIA VIDEO

- VIDEO/ E rëndë në Mamurras, shëkëputet ballkoni i katit të pestë dhe përfundon një kat më poshtë, tmerrohen banorët**
13 Shtator, 2022
- "Shqipëria parajsë e mafies", Meta thirrje administratës: Mos u përdorini nga Rama! Me protesta do vendosim demokracinë, do shkojmë në çdo skenë krimi!**
13 Shtator, 2022
- "Po paguajmë taksin e korrupsionit", ish-deputetja nga protesta: Nuk justifikohen 128 mln euro duke mbjellë pemë!**
13 Shtator, 2022
- "Mjaft mbi!", Meta thirrje SPAK: Hiqeni shaminë që ju ka vënë Rama në sy, çoni hajdutët dhe rilindasit pas hekurave!**
13 Shtator, 2022
- "Do jetë vjeshta e përballjes", deputeti i PD, Spaho nga protesta e Partisë së Lirisë: Ku janë peshqit e mëdhenj të arrestuar? Ku është SPAK-u me aferën e inceneratorëve?!**
13 Shtator, 2022
- Regjisori Budina me tone të forta nga inceneratori i Tiranës: Bandat po bëjnë ligjin në këtë vend, ta shporrim!**
13 Shtator, 2022

FAQET ZYRTARE

TV News24 Live
News24.al
Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert
Autoktonët
Dola te Ola
Emisioni Vila 24
Fit Station
Frontline
Jeta pa filter
Kjo javë
Klinika 24
Koha për t'u zgjuar
Me zemër të hapur
Në mëngjes me Klarkun
Në shënjestër
Open
Pikat mbi i
Rrugëtim me Anilën
Sport News
Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today

